# KIRFN Interpretimi 17
## *Shpërndarja e Aktiveve Jo-Monetare tek Pronarët*

## Referencat

- SNRF 3 *Kombinimet e Biznesit* (rishikuar në 2008)
- SNRF 5 *Aktivet Afatgjata të Mbajtura për Shitje dhe Operacionet Jo të Vijueshme*
- SNRF 7 *Instrumentet financiare: Dhënia e informacioneve shpjeguese*
- SNRF 10 *Pasqyrat financiare të konsoliduara*
- SNRF 13 *Matja me Vlerën e Drejtë*
- SNRF 18 *Paraqitja dhe Dhënia e Informacioneve Shpjeguese në Pasqyrat Financiare*
- SNK 10 *Ngjarjet pas periudhës raportuese*

## Historiku

1 Ndonjëherë një njësi ekonomike shpërndan aktive dhe jo mjete monetare (aktive jo monetare) si dividendë për pronarët e saj të cilët veprojnë në aftësinë e tyre si pronarë. Në këto situata, një njësi ekonomike mund t'u japë pronarëve të saj një zgjidhje për të marrë ose aktive jo-monetare ose një alternativë në mjete monetare. KIRFN mori kërkesa për udhëzime se si një njësi ekonomike duhet të kontabilizojë këto shpërndarje.

2 Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF-të) nuk japin udhëzime sesi një njësi ekonomike duhet t'i masë shpërndarjet tek pronarët e saj (të referuara gjerësisht si dividendë). SNRF 18 kërkon që një njësi ekonomike të paraqesë detaje të dividendëve të njohur si shpërndarje tek pronarët në pasqyrën e ndryshimeve në kapitalin neto ose të japë informacione shpjeguese në shënimet.

## Objekti

3 Ky interpretim aplikohet në llojet e mëposhtme të shpërndarjeve jo-reciproke të aktiveve nga një njësi ekonomike tek pronarët e saj të cilët veprojnë në aftësinë e tyre si pronar:

(a) shpërndarja e aktiveve jo-monetare (p.sh. zërat e aktiveve afatgjata materiale, bizneset siç përcaktohen në SNRF 3, interesat e pronësisë në një njësi tjetër ekonomike ose grupe të nxjerra jashtë përdorimit siç përcaktohet në SNRF 5); dhe

(b) shpërndarja e cila i jep pronarëve një mundësi për të marrë ose aktive jo monetare ose një alternativë të mjeteve monetare.

4 Ky Interpretim zbatohet vetëm për shpërndarjet ku të gjithë pronarët e të njëjtës klasë të instrumenteve të kapitalit neto trajtohen në mënyrë të barabartë.

5 Ky Interpretim nuk zbatohet për një shpërndarje të aktiveve jo-monetare e cila kontrollohet së fundmi nga e njëjta palë ose palët përpara ose pas shpërndarjes. Ky zbatohet aplikohet në pasqyrat financiare individuale, të veçanta dhe të konsoliduara të një njësie ekonomike e cila kryen shpërndarjen.

6 Në përputhje me paragrafin 5, ky Interpretim nuk zbatohet kur aktivi jo–monetar kontrollohet së fundmi nga të njëjtat palë si përpara dhe pas shpërndarjes. Paragrafi B2 i SNRF 3 citon se 'Një grup individësh do të konsiderohet si kontrollues i një njësie ekonomike kur, si rezultat i marrëveshjeve kontraktuale, ato së bashku kanë pushtet për të drejtuar politikat e saj financiare dhe operuese në mënyrë që të sigurojnë përfitime nga veprimtaritë e saj'. Për këtë arsye, për një shpërndarje e cila është jashtë qëllimit të këtij Interpretimi mbi bazën që të njëjtë palë të kontrollojnë aktivin si përpara dhe pas shpërndarjes, një grup i aksionarëve individualë që marrin shpërndarjen duhet detyrimisht, si rezultat i marrëveshjeve kontraktuale, të kenë këtë pushtet vendimmarrës të përbashkët mbi njësinë ekonomike e cila kryen shpërndarjen.

7 Në përputhje me paragrafin 5, ky Interpretim nuk zbatohet kur një njësi ekonomike shpërndan disa prej interesave të saj të pronësisë në një filial por ruan kontroll të filialit. Njësia ekonomike e cila kryen një shpërndarje që rezulton në njohjen e interesave jo- kontrolluese të njësisë ekonomike në filialin e saj kontabilizohet për shpërndarje në përputhje me SNRF 10.

8 Ky Interpretim i adresohet vetëm kontabilitetit të një njësie ekonomike e cila kryen shpërndarje të aktivit jo-monetar. Ai nuk trajton kontabilitetin sipas aksionarëve që e marrin këtë shpërndarje.

## Çështjet

9 Kur një njësi ekonomike deklaron një shpërndarje dhe ka një detyrim për të shpërndarë aktivet që i përkasin pronarëve të saj, ajo duhet detyrimisht të njohë një detyrim për dividendin e pagueshëm. Si rrjedhojë, ky Interpretim trajton çështjet e mëposhtme:

(a) Kur duhet njësia ekonomike të njohë dividendin e pagueshëm?

(b) Si duhet ta masë një njësi ekonomike dividendin e pagueshëm?

(c) Kur një njësi ekonomike shlyen dividendin e pagueshëm, si duhet të kontabilizojë diferencat midis vlerës kontabël neto të aktiveve të shpërndara dhe vlerën kontabël neto të dividendit të pagueshëm?

## Konsensusi

### Kur njihet një dividend i pagueshëm

10 Detyrimi për të paguar një dividend do të njihet kur autorizohet zbatimi i dividendit dhe nuk është më nën juridiksionin e njësisë ekonomike, e cila përkon me datën:

(a) kur deklarimi i dividendit, p.sh. nga drejtoria ose bordi i drejtorëve, miratohet nga autoriteti përkatës, p.sh. aksionarët, nëse juridiksioni e kërkon këtë miratim, ose

(b) kur dividendi deklarohet, p.sh. nga drejtoria ose bordi i drejtorëve, nëse juridiksioni nuk kërkon aprovim të mëtejshëm.

### Matja e një dividendi të pagueshëm

11 Një njësi ekonomike mat një detyrim për të shpërndarë aktive jo-monetare si një dividend tek pronarët e saj në vlerën e drejtë të aktiveve që priten të shpërndahen.

12 Nëse një njësi ekonomike i jep pronarëve një zgjidhje për të marrë ose një aktiv jo monetar ose një alternativë të mjeteve monetare, njësia ekonomike duhet të vlerësojë dividendin e pagueshëm duke marrë në konsideratë si vlerën e drejtë të çdo alternative dhe probabilitetin e lidhur të pronarëve që përzgjedhin secilën alternativë.

13 Në fund të çdo periudhe raportuese dhe në datën e shlyerjes, njësia ekonomike rishikon dhe rregullon vlerën kontabël neto të dividendit të pagueshëm , me çdo ndryshim në vlerë kontabël të dividendit të pagueshëm të njohur në kapital neto si rregullime të vlerës së shpërndarjes.

### Kontabilizimi për çdo diferencë midis vlerës kontabël neto të aktiveve të shpërndara dhe vlerës kontabël neto të dividendit të pagueshëm kur një njësi ekonomike shlyen dividendin e pagueshëm

14 Kur një njësi ekonomike shlyen dividendin e pagueshëm, ajo njeh diferencën, nëse ka, midis vlerës kontabël të aktiveve të shpërndara dhe vlerën kontabël të dividendit të pagueshëm në fitim ose humbje.

### Paraqitja dhe shënime shpjeguese

15 Një njësi ekonomike paraqet diferencën e përshkruar në paragrafin 14 si një nën zë të veçantë në fitim ose humbje.

16 Një njësi ekonomike paraqet informacionin e mëposhtëm, nëse aplikohet:

(a) vlerën kontabël të dividendit të pagueshëm në fillim dhe fund të periudhës financiare; dhe

(b) rritjen ose rënien e vlerës kontabël të njohur në periudhën raportuese në përputhje me paragrafin 13 si rezultat i një ndryshimi në vlerë të drejtë të aktiveve që priten të shpërndahen.

 © Fondacioni i SNRF-ve

17 Nëse, pas përfundimit të një periudhe raportuese financiare por përpara autorizimit për emetim të pasqyrave financiare, një njësi ekonomike deklaron një dividend për shpërndarjen e aktiveve jo-monetare, ajo duhet të japë informacion shpjegues mbi:

(a) natyrën e aktivit që do të shpërndahet;

(b) vlerën kontabël të aktivit që pritet të shpërndahet në fund të periudhës së raportimit financiar; dhe

(c) vlerën e drejtë të aktivit që pritet të shpërndahet në fund të periudhës së raportimit financiar, nëse është i ndryshëm nga vlera e tij kontabël, dhe informacionin mbi metodën(metodat) e përdorura për të matur këtë vlerë të drejtë të kërkuar nga paragrafët 93(b), (d), (g) dhe (i) dhe 99 të SNRF 13.

## Data e hyrjes në fuqi

18 Një njësi ekonomike e zbaton këtë Interpretim siç duhet për periudha vjetore që fillojnë ne ose pas datës 1 korrik 2009. Zbatim retrospektiv nuk lejohet. Lejohet zbatimi përpara kësaj date. Nëse një njësi ekonomike e zbaton këtë Interpretim për një periudhë e cila nis përpara datës 1 korrik 2009, ajo do ta paraqesë këtë fakt dhe të zbatojë gjithashtu SNRF 3 (siç u rishikua në 2008), SNK 27 (siç u ndryshua në maj 2008) dhe SNRF 5 (siç u ndryshua nga ky Interpretim).

19 SNRF 10, e publikuar në maj 2011, ndryshoi paragrafin 7. Njësia ekonomike do t'i zbatojë këto ndryshime, kur zbaton SNRF 10.

20 SNRF 13, e publikuar në maj 2011, ndryshoi paragrafin 17. Njësia ekonomike do t'i zbatojë këto ndryshime, kur zbaton SNRF 13.

21 SNRF 18, i publikuar në prill 2024, ndryshoi paragrafin 2. Njësia ekonomike duhet të zbatojë këto ndryshime, kur zbaton SNRF 18.

## Shtojca
## Ndryshimet në SNRF 5 Aktivet afatgjata të mbajtura për shitje dhe veprimtaritë e ndërprera dhe SNK 10 Ngjarjet pas periudhës raportuese

*Ndryshimet e përfshira në këtë shtojcë kur ky Interpretim u publikua në vitin 2008 janë përfshirë në SNRF 5 dhe SNK 10 të publikuara në këtë vëllim.*

 © Fondacioni i SNRF-ve